

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm , Gjyqtarja **Ilirjana Hoti** , me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në çështjen penale kundër të akuzuarve A. K. dhe M. K. qe te dy nga Gjakova , për shkak te veprave penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188/3-1-1.1te KPRK-ës , sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore -DP në Gjakovë, PP/II.nr.1218/17 të datës 09.11.2017, në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur më datë **18.09.2018**, në prani të Prokurorit të shtetit Xh. O. ,të dëmtuarës A. K. , mbrojtësit te viktimave A. P. si dhe te akuzuarve A. K. dhe M. K., me dt. 21.09.2018 mori dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **A. K.** , i biri P. dhe i K. e gjinisë P., data e lindjes, Gjakovë, tani me banim ne Rr.”..... ” ,lagjja B....., ku edhe tani banon, ,ka te kryer shkollën e mesme , punëtor teknik ,i gjendjes se mesme ekonomike, shqiptar ,shtetas i R. Kosovës martuar , atë i 2 fëmijëve , me nr. ID

E akuzuara **M. K.** , e bija e Sh. dhe e nënës F. e gjinisë N. , data e lindjes ... ne fsh. F. K Gjakovë , tani me banim ne Prishtinë , ad.P.B. H. I. G., lagjja M. , ,ka te kryer shkollën fillore , frizere , e gjendjes dobët ekonomike , shqiptare , shtetase e R. Kosovës, e martuar , nenë e 2 fëmijëve, me nr. ID

I pandehuri A. K. :

Ë s h t ë f a j t o r

Sepse :

I.

- më dt. **30.07.2017** ,rreth orës **12.50 min**, në Gjakovë ,Rr ”.....”,pikërisht ne sallonin e bukurisë “.... “, i shkakton lëndime trupore te dëmtuarës –vajzës se tij A. K. , ne atë mënyrë qe përderisa vajzat e te pandehurit , e dëmtuara A. K. dhe K. K. ,kishin një mosmarrëveshje ne mes tyre , bashkëshortja e tij M. K. e thërret te pandehurin që ta zgjidhë mosmarrëveshjen ne mes vajzave te tyre, i cili me te arritur fillimisht kërkon nga vajzat qe te qetësohen ,por pasi qe e dëmtuara A.nuk e dëgjon , i pandehuri e godet te dëmtuarës ne fytyre dhe pjesë tjera t trupit ,me ç ‘rast i shkakton lëndime te lehta trupore , me pasoja te përkohshme te shëndetit , te konstatuara sipas ekspertizës mjeko –ligjore te dt. 02.10.2017

- me çka ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188/3 lidhur me par.1pika 1.1. të KPRK-së ,

II.

- me datë , kohë dhe vend si ne piken e I-rë te aktakuzës ,i shkakton lëndime trupore te dëmtua resë –bashkëshortes se tij M. K. ,ne atë mënyrë pasi e dëmtuara i vërsulet te pandehurit , i pandehuri e godet në fytyrë edhe pjesë tjera te trupit ,me ç ‘rast te dëmtuarës i shkakton lëndime te lehta trupore ,me pasoja te përkohshme te konstatuara sipas ekspertizës mjeko –ligjore te dt. 02.10.2017.

- me çka ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188/3 lidhur me par.1pika 1.1. të KPRK-së ,

E pandehura M. K. :

Ë s h t ë f a j t o r e

Sepse :

III.

-me datë, kohë dhe vend si ne piken e I-rë te aktakuzës , i shkakton lëndime trupore te dëmtuarit -bashkëshortit te saj A. K. , ne atë mënyrë qe i vërsulet te dëmtuarit A. dhe e godet në pjesën e majtë te fytyrës, me ç ‘rast lëndime te lehta trupore, me pasoja te përkohshme te shëndetit , te konstatuara sipas ekspertizës mjeko –ligjore te dt. 02.10.2017.

- me çka ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188/3 lidhur me par.1pika 1.1. të KPRK-së ,

Andaj gjykata në bazë te nenit 4,41,43,49,50,51,73 të KPRK-ës , nenit 188 par. 3lidhur me par.1 pika 1.1 të KPRK-së dhe nenit 365 të KPPK-ës,

Të akuzuarit A. K., i shqipton:

- Për veprën penale te përshkuar ne piken I-rë të dispozitivit lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 3 lidhur me par.1 pika 1.1 te KPRK-ës, dënim me burgim ne kohëzgjatje prej **4(katër) muajve** ,i cili dënimi nuk do te ekzekutohet nëse të akuzuarit brenda kohës se verifikimit ne afatin prej **1 (një) viti** ,nuk kryejnë ndonjë vepër tjetër penale .

- Për veprën penale te përshkuar ne piken II-të të dispozitivit lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 3 lidhur me par.1 pika 1.1 te KPRK-ës, dënim me burgim ne kohëzgjatje prej **4(katër) muajve** ,i cili dënimi nuk do te ekzekutohet nëse të akuzuarit brenda kohës se verifikimit ne afatin prej **1 (një) viti** ,nuk kryejnë ndonjë vepër tjetër penale.

Gjykata bazuar ne nenin 80 te KPRK-ës ,i shqipton :

DËNIM ME KUSHT

Dënimin unik me burgim ne kohëzgjatje prej **6(gjashtë) muajve** ,i cili dënimi nuk do te ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës se verifikimit në afatin prej **1 (një) viti** ,nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale .

Të akuzuarës M. K., i shqipton:

DËNIM ME KUSHT

Dënim me burgim ne kohëzgjatje prej **4(katër) muajve** ,i cili dënimi nuk do te ekzekutohet nëse e akuzuara brenda kohës se verifikimit ne afatin prej **1 (një) viti** ,nuk kryejnë ndonjë vepër tjetër penale .

E dëmtuara A. K. dhe të dëmtuarit - akuzuarit për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest civil.

Detyrohen të akuzuarit që në mënyrë solidare në emër të kompensimit të viktimave të krimit ti paguaj shpenzimet në shumë prej 30,00 €, shpenzimet procedurale në emër të ekspertizës mjeko - ligjore shumë prej 50,00.- € si në emër të paushallit gjyqësor shumë prej nga 20,00.-€, në afat prej 15 ditësh, e krejt këtë pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi..

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore DP në Gjakovë ,ka ngritë aktakuzën PP/II.nr.1218/17 të datës 09.11.2017, kundër të akuzuarve A. K. dhe M. K. nga Gjakova, për shkak te veprave penale lëndim i lehte trupor nga neni 188/3-1-1.1 të KPRK-ës, duke propozuar që të akuzuarit të shpallen fajtor , të dënohen sipas ligjit dhe të obligohen në pagesën e shpenzime procedurale.

Në shqyrtimin gjyqësor te dt. 18.09.2018, Prokurori i shtetit Xh. O. , mbeti në tërësi pranë Aktakuzës PP/II.nr.1218/17 të dt. 09.11.2017 dhe propozoi që pas shqyrtimit gjyqësor të akuzuarit të shpallen fajtor dhe të dënohen . Ne fjalën e tij përfundimtare deklaroi se pas shqyrtimit gjyqësor dhe nxjerrjes se provave një nga një ne tërësi veçmas me dëgjimin e dëshmitares –vajzave te tyre K. K., si dhe akt ekspertizës mjeko ligjore te lëshuar nga mjekësia ligjore është vërtetuar gjendja faktike si ne aktakuzë PP/II nr. 1218/17 te dt.09.11.2017 , sa i përket te akuzuarës M. K. ,ndërsa për te akuzuarin A. K. nuk kam vërejtje dhe e çmojë pranimin e vullnetshëm te tij i cili pranim ka qene ne te gjitha fazat e procedurës ne mënyrë te vullnetshme . Gjykatës i le ne dijeni se te dy nuk kanë qene te njohur me pare dhe nuk kanë evidencë mbi dënueshmërin e tyre ,pas rastit jetojnë ndaras , e njëjta jeton ne Prishtinë dhe nga rasti nuk ka ardhur te raportojë diçka qe rasti te jete përsëritur .Mbetem ne tërësi pranë aktakuzës dhe i propozoi gjykatës te njëjtat te shpallen fajtor , te dënohen sipas ligjit dhe te obligohen ne pagesën e shpenzimeve procedurale.

E dëmtuara A. K., ne fjalën përfundimtare deklaroi se i bashkëngjitë ndjekjes penale dhe kërkon kompensim demi sa i përket të akuzuarit A. K. .

Mbrojtësi i viktimave A. P.,ne fjalën përfundimtare deklaroi se e mbështet ne tërësi fjalën përfundimtare te dëmtues A. K. dhe nuk kam çka te shtojë se pasi qe e njëjta ka qene si palë e dëmtuar dhe kërkon nga gjykata qe te ndërmerren masa këtu ndaj te pandehurit .

I akuzuari A. K., gjatë shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me dt.18.09.2018 , duke u deklaruar lidhur me fajësinë thekson se e pranon në tërësi fajësinë për veprat penale për të cilat akuzohet ashtu si qëndron në dispozitiv të aktakuzës dhe atë në mënyrë vullnetare dhe pa presion duke i ditur edhe më parë pasojat dhe favoret e pranimin të fajësisë. Në mbrojtjen e tij duke u përgjurr në pyetjet e parashtruara nga prokurori i shtetit ka deklaruar se më nuk jetojmë bashkë meqenëse ka shkuar në Prishtinë së bashku m vajzën A.dhe ka hapur biznesin e saj dhe pas rastit jemi në proces të divorcit. Në pyetjen e gjykatës i akuzuari ka deklaruar , pasi ishte rrëmujë nuk mund të di se nga kush i kam marr lëndimet por të njëjtat besojë se i kam marr nga M. , meqenëse unë nuk e kam vërejtur veten në atë moment por nga policia jam dërguar në emergjencë ku janë konstatuar lëndimet. Në fjalën e tij përfundimtare theksoi se mbetem ne tërësi pranë parashtrimeve te paraqitura gjate këtij shqyrtimi si dhe ne fazat e mëhershme ,shprehi keqardhje para gjykatës për rastin qe ka ndodhur ne afekt , me qene se unë asnjëherë me pare nuk kam ushtruar dhune fizike apo psikike ndaj familjareve te mi e posaçërisht ndaj vajzës sime. I propozoi gjykatës me rastin e marrjes se vendimit mbi lartësin e dënimit te merr parasysh rrethanat lehtësuese si pranimi i fajësisë ne çdo fazë e procedurës , kërkim falja për lëndimet e shkaktuar nga te dëmtuarat si dhe faktin se asnjëherë me pare nuk kam ra ndesh me ligjin te me shqiptojë një dënim me te butë .

E akuzuara M. K. ,gjatë shqyrtimit gjyqësor duke u deklaruar lidhur me fajësinë ka theksuar se nuk e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet sipas aktakuzës dhe kërkojë nga

grykata të lirohem nga akuza .Në mbrojtjen e saj duke u deklaruar në pyetjet e parashtruar nga ana e prokurorit të shtetit se kush ia ka shkaktuar lëndimet këtu të akuzuarit A. K. ka theksuar se unë isha ne vend punim dhe ky ka ardhur dhe e ka rrahur vajzën ,unë kam zbritur poshtë ne podrum që ta nxjerr vajzën nga duart e tij por i njëjti nga pas me ka kapur për flokë dhe me ka goditur pas shpine e jo përpara.

Pas deklarimit të akuzuarit A. K. për fajësinë e tij e ,Grykata refuzoi pranimin e fajësisë ndaj të akuzuarit A. K. ,pasi e akuzuara M. K. nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale me të cilën ngarkohet ,Grykata refuzoj pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit A. K. dhe shqyrtimin gjyqësor e ka vazhduar me administrimin e provave.

Pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit gjyqësor dhe administrimit të provave dhe vlerësimit të tyre një nga një dhe në lidhje me provat tjera , konform nenit 361 të KPPK-ës ,Grykata vërtetoi gjendjen faktike si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi ,andaj me veprimet e të akuzuarve ekzistojnë të gjitha tiparet e veprave penale të lëndimit të lehtë trupor nga neni 188 par. 3 lidhur me par 1 pika 1.1 të KPRK-ës, për të cilën vepër të akuzuarit janë penalisht përgjegjës dhe janë ndëshkuar si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi , pasi që në rastin konkret nuk ka gjetur asnjë rrethanë e cila kishte për ta përgjashtuar përgjegjësia penale.

Grykata deri te ky konstatim ka ardhur pas dëgjimit të dëmtuarës A. K. në cilësinë e dëshmitares, dëshmitares K. K. si dhe ka administruar provat materiale dhe atë: raporti fillestar i incidentit me nr. rastit dt. 30.07.2017,raporti i oficerit F. H. me numër dhe datë te njëjte ,i raportet nga reparti i emergjencës të Spitalit Rajonal “....” në Gjakovë me nr.ne emër te A. K. ,nr ne emër te A.A. K. , dhe nr. 9775 në emër te M. K. të dt. 30.07.2017 si dhe akt ekspertimin mjeko ligjor me nr. Ref. dt. 02.10.2017 nga eksperti mjeko ligjor Dr. N. U.,mbi natyrën e lëndimeve te A. K. ,A. K. dhe M. K. , dhe nga vet deklarimi i të akuzuarve të parashtruar gjatë mbrojtjes së tyre, Grykata gjeti se këto prova ofrojnë bazë të mjaftueshme , të njëjtat vërtetojnë se të akuzuarit në kohë , vend dhe mënyrë të përshkruar si në dispozitiv të këtij Aktgjykimit kanë kryer veprat penale me të cilat ngarkohen.

E dëmtuara A. K. , gjatë dëshmisë së saj të dhënë në shqyrtimin gjyqësor të dt. 18.09.2018, duke u përgjigjur fillimisht në pyetjet e Prokurorit ka deklaruar se që të dy të akuzuarit i ka prind, pas këtij rasti nuk jetojmë së bashku por unë jetoj me nënën dhe se pas këtij rasti nuk kemi pasur kontakte me te . Rasti ka ndodhur me dt. 30.07.2017 , ka qene ditë e diel , nga ora 12.30 apo 13.00 ,nuk me kujtohet saktë. Ne fillim unë me motrën time kishim një mosmarrëveshje ne dyqanin e nënës sime , me pas nëna na ka thënë te dyjave qe te zbresim në podrum që të vazhdojmë bisedën. Mosmarrëveshja mes meje dhe motës ishte se motra ime ka hapur dy instagrame te rreme , me pas kemi nis te bërtasim me të madhe gjatë asaj mosmarrëveshje , ku nena ime pas dëgjimit te zërave ka thirr babën qe te vije e te na qetësojë dhe te shohë se çka po ndodh, kur ka ardhur ai ne podrum ka filluar te na dëgjojë bisedën tonë e me pas ka filluar te mbajë anën e motrës time duke me bërtitur mua, pasi qe nuk i pëlqyen fjalët e mija fillojë të më bërtas dhe me ka goditur në fytyrë e më pas në krejt trupin ku edhe më ka rrëzuar nga karrika ,duke vazhduar ne këtë mënyrë edhe pse unë kam bërtitur. Kur nëna ka dëgjuar britmën time ka zbritur ne podrum dhe sa me ka parë mua për toke ka ndërhyre në mes ti pengojë goditjet nga babai , ne atë moment kur me ka kapur mua qe te me ngritë , babai e ka kapur edhe nënën për flokë dhe e ka gjuajtur për tokë , ku me pas fillon edhe me grushte e shqelma duke bërtitur pa u ndalur sa qe unë as nuk e kam vërejtur nënën pasi qe e kishte mbuluar te teren .Goditjet ndaj saj kanë vazhduar ku ka filluar te bërtas edhe nena nga dhimbjet ,me pas tezja dhe burri i tezes që ishin në sallon kanë dëgjuar ,kanë zbritur poshtë dhe me mund shume te madhe e kanë hekur nënën nga duart e babait .Pastaj nena ka shkuar lartë ne sallon dhe e fton policinë. Unë nuk e di se kush ja ka shkaktuar lëndimet babait këtu të akuzuarit A.. Në pyetje e parashtruar nga mbrojtësi i viktimave se çfarë raporte familjare kanë pasur mes veti para se me ndodh rasti?

Dëshmitarja ka deklaruar se babi me nënën nuk i kanë pasur raportet e mira sidomos 4 vitet e fundit , e tu marr parasysh ngjarjen që ka ndodhur atë ditë i kanë pasur raportet shumë të këqija gjatë tërë javës por edhe raportet e mija me babanë nuk kanë qenë aspak të mira ndërsa me nënën kanë qenë raportet shumë të mira. Po ashtu me motrën kemi pas mosmarrëveshje gjatë tërë javës.

Dëshmitarja K. K. , gjatë dëshmisë së saj të dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor me dt. 18.09.2018, duke u përgjigjur fillimisht në pyetjet e Prokurorit, ka deklaruar se më kujtohet ngjarja , ne e dimë se gjithçka nuk fillon vetëm për një ditë , para se me ndodh rasti kemi pasur mbledhje familjare ku një shoqëri e pa dëshiruar ishte futur ne familjen tonë ,aty kemi vendos qe ajo familje mos me ardhur ne familje, ishim te gjithë pjesëtarët e familjes e po ashtu edhe djali i hallës ishte prezent ,babai na pyeti se a doni te vazhdoni qe ajo familje te vije apo jo , por gjyshi si kryefamiljar shprehi mendimin se ajo familje nuk duhet te vijë ne shtëpinë tonë e as te kemi kontakte meta. Te nesërmen në mbrëmje një nga punëtorët e sallonit u largua nga puna dhe ajo na patë treguar se po largohet se nena ishte bere e padurueshme për te dhe i ka dorëzuar çelësat ..Kështu qe edhe unë vendosa te lëshojë punën duke i treguar prindërve qe nuk do te punojë as unë me ne sallon ,por me qene se te nesërmen e dija qe kisha termin afërsisht ne ora 12.00 , e thirra ne telefon babin që të vij e të më merr por nuk u lajmëruar në telefon . Unë u mora vesh me motrën e cila e lajmëroi babën ku babi me telefonojë mua dhe me tha se nena ka marr një kantë me benzinë dhe po do me e kallë sallonin , unë i thashë se jam ka vijë , ai me tha mos hajde ti sot se nuk është mirë ,jam nisur ne këmbë por kur kam arritur te “... “ aty me ka marr me kerr babi dhe me tha se nena dhe motra janë duke folur keq për mua ,vajzën e dajës dhe gruan e dajës dhe tha se janë ka e përmendin një instagram .Kur arrita ne sallon pasi kishte klient kërkova nga motra qe te zbresim poshtë ne podrum ku edhe nena ne tha shkoni poshtë .Aty poshtë kemi filluar te fjalosemi për instagram me motrën ,bërtitnim me zë te lartë duke u sqaruar mes veti po pa u gjuajtur ,nëna e ka dërguar babin qe te na qetësojë ,ne ishim duke u fjalosur pa u ndal dhe babai nga tha qe te qetësoheni ,por ishte e kotë se A.nuk u ndalke dhe vazhdojë ne formë me agresiviteti ndaj babait ,ku babai e goditi dy here ne fytyrë dhe një here ne këmbë , gjë e cila është e vërtetuar nga mjeku .Vjen mami nga lartë pasi dëgjon zërin e A. dhe i vërsulet babit se ma mbyte vajzën e qe ne realitet nuk ishte ne pyetje diçka e mardhe por vetëm dy shuplaka . Në pyetjen se a e ke parë nënën duke e goditur babën ?dëshmitarja ka deklaruar se po e kam parë me qene se unë isha duke e tërhequr motrën e cila ishte duke e sulmuar babën por nuk e kam pare se i ka ra ajo babës ,ne atë moment kanë ardhur te zja dhe burri i tezes e qe ishin ne sallon lartë te ftuar nga babi .Kur ka ardhur te zja me burrin e saj poshtë burri i tezes i ka thënë babait qe t’ia le ne dorën këtë punë pasi qe na ke thirrur për këtë. Mami është ngjitur lartë ne sallon , me pas edhe unë , por nuk kanë kaluar as dy minuta kur ka ardhur policia e qe as unë nuk e di sek ush e ka lajmëruar policinë . Në pyetjen e mbrojtësit e viktimave A. P.: si kanë qene raporte e juaja familjare para se te ndodh rasti ?dëshmitarja ka deklarua se : mami pak e ka pas humbur durimin , me arsyttime te saja shëndetësore (klimaksi etj) , me motrën kemi pasur raporte shume te mira e cila edhe është kujdesur për fëmiun tim kur unë punoja gjate sezonit ne sallon deri ne ditën kritike .Baba me nënën raportet i kishin jo te mira, flinin ndaras për afërsisht 4 muaj , mami ka fjetur me motrën dhe shpesh here para se te ndodh rasti ne sallon mbajtshim debate e qe ishte ne dijeni edhe motra se mami na patë tregu se duhet me i tregu babit se donë me u nda në mënyrë që ta le me te qete qe te del me shoqërinë e saj. Po ashtu ka pas edhe reagime tjera kur babi kthehej nga puna për ne sallon , nëna si shenjë pakënaqësie thoshte ”se çka lyp ai ne sallon”. Në pyetjen e mbrojtësit të viktimave se a e ke parë duke goditur baba nënën dhe anasjelltas nëna babën ?dëshmitarja ka deklaruar : po te dy i kam parë ,kur zbret mami poshtë i është vërsulur babait duke i thënë se je ka do me e mbyt vajzën , është fjala për A. dhe babi ia kthen ne te njëjtën mënyrë ku edhe vazhdon përleshja mes tyre, .me shuplaka e ndoshta edhe me boksa njeri tjetrin , kam vërejtur se babi ka pasur gjak në faqe ndërsa te nëna dhe A.nuk kam vërejtur gjak . Në pyetjen se ju deklaruat se baba ka pasur gjak ne faqe por a ka mund te ndodh qe ky lëndim te vije nga vetëmbrojtja ?dëshmitarja deklaroi se unë nuk e di duhet te pyetet nena me qe ajo ia ka shkaktuar këtë lëndim .Në pyetjen e gjykatës ju thatë se ka zbrit nena nga lartë ne podrum dhe a di se cili ju ka vërsul i pari njeri tjetrit

,dëshmitarja ka deklaruar se nuk mundem me thanë se cili por nena se pari iu ka vërsul babait por kush kujtë i ka gjuajtur i pari nuk di se nuk kam mundur te koncentrohem .

Nga leximi i raportit të i oficerit F. H. , me numër PK .nr.10048 të dt. 30.07.2017, me numër të rastit, gjykata ka vërtetuar faktin se në këtë raport janë përshkruar veprimet hetimore të ndërmarra nga oficeri hetimor F. H. .

Nga leximi i Raportit të shkurt të përpiluar nga oficeri Arben shala , me PK nr. 1544 të dt.30.07.2017, me numër të rastit , gjykata ka vërtetuar faktin se me dt.30.07.2017, në ora 12.55min , në Rr”” në Gjakovë, kishte ndodhur një rast (dhune në familje) , ku i dyshuari A. K. kishte sulmuar fizikisht bashkëshorten e tij si dhe vajzën e tij duke i shkaktuar lëndime të lehta trupore . Viktimave ju është ofruar tretman mjekësor dhe sipas raportit mjekësor lëndimet kanë qenë të lehta . Viktimat janë intervistuar si dhe është njoftuar mbrojtësi i viktimave . Edhe te dyshuarit ju është ofruar tretmani mjekësor pasi kishte disa gërvishtje , ku pas intervistimit i dyshuari me urdhër të prokurorit kujdestar dërgohet në mbajtje.

Nga raportet e repartit të emergjencës me nr.... në emër të A. K.,nr.... në emër të A.A. K. dhe nr. në emër të M. K.t të gjitha të dt. 30.07.2017, konstatohet se e dëmtuara A. K. , të akuzuarit- të dëmtuarit A. K. dhe M. K. si rezultat i lëndimeve të pësuarra kanë marr trajtim mjekësor në repartin e emergjencës.

Nga akt ekspertimi mjeko-ligjor i dr.N. U. , konstatohet se natyra e lëndimeve trupore të dëmtuarës A. K. i përkasin natyrës së lehtë e po ashtu edhe për të akuzuarit-dëmtuarit A. dhe M. K. konstatohet se natyra e lëndimeve i përkasin natyrës së lehtë .

Nga akt ekspertimi mjeko ligjor Dr. N. U., është konstatuar se e akuzuara -dëmtuara M. K.,ka gërvishtje në regjionin e majtë të fytyrës , regjionin e bërrylave të duarve dhe regjionin e mbi gjurit të djathtë , të shkaktuara nga veprimi mekanik i mjetit të fortë , mbretës (jo i mprehtë) me pasoja të përkohshme në shëndet.

Nga akt ekspertimi mjeko ligjor Dr. N. U., është konstatuar se e akuzuari –i dëmtuari A. K. ka gërvishtje në regjionin e majtë të fytyrës , të shkaktuara nga veprimi mekanik i mjetit të fortë , mbretës (jo i mprehtë) me pasoja të përkohshme në shëndet.

Gjykata pas administrimit të provave , analizimit të tyre më shumë kujdes gjatë shqyrtimit gjyqësor , ka konstatuar si jokontestues faktin se me dt. dt.30.07.2017, rreth 12,50 min , në Gjakovë pikërisht në sallonin e bukurisë “....”, i akuzuari A. K. i ka shkaktuar lëndime trupore vajzës së tij A. K. , në atë mënyrë përderisa vajzat e të pandehurit A. K. dhe K. K. kishin një mosmarrëveshje në mes tyre , bashkëshortja e tij M. K. e thërret të pandehurin që ta zgjidh mosmarrëveshjen në mes vajzave të tyre , i cili me të arritur fillimisht kërkon nga vajzat që të qetësohen ,por pasi e dëmtuara A.nuk e dëgjon , i pandehuri e godet të dëmtuarën në fytyrë dhe në pjesë tjera të trupit . Po ashtu ka konstatuar si jokontestues faktin me datë , kohë dhe vend si ne piken e I-rë te aktakuzës ,i shkakton lëndime trupore te dëmtuarës -bashkëshortes se tij M. K. ,ne atë mënyrë pasi e dëmtuara i vërsulet te pandehurit , i pandehuri e godet në fytyrë edhe pjesë tjera te trupit ,me ç ‘rast te dëmtuarës i shkakton lëndime te lehta trupore. Ky fakt është vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari në çdo fazë të procedurës e po ashtu edhe nga deklarata e dhënë nga e dëmtuara A. K. e cila në cilësi të dëshmitares gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se ditën kritike unë me motrën time kishim një mosmarrëveshje ne dyqanin e nenës sime , me pas nena na ka thënë te dyjave qe te zbresim ne podrume te vazhdojmë bisedën , mosmarrëveshja mes meje dhe motës ishte se motra ime ka hapur dy instagrame te rreme , me pas kemi nis te bërtasim me te madhe gjate asaj mosmarrëveshje , ku nena ime pas dëgjimit te zërave ka thirr babën qe te vije e te na qetësojë dhe te shohë se çka po ndodh, kur

ka ardhur ai ne podrum ka filluar te na dëgjojë bisedën tonë e me pas ka filluar te mbajë anën e motrës time duke me bërtitur mua, pasi qe nuk i pëlqyen fjalët e mija fillojë te me bërtas dhe me ka goditur ne fytyre e me pas ne krejt trupin ku edhe me ka rrezuar nga karrige ,duke vazhduar ne këtë mënyrë edhe pse unë kam bërtitur, si dhe deklarata e dëshmitares K. K.-K., të dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor e cila ka deklaruar se : Ditën kritike kur arrita ne sallon pasi kishte klient kërkova nga motra qe te zbresim poshtë ne podrum ku edhe nena na tha shkoni poshtë , poshtë kemi filluar te fjalosemi për instagram me motrën ,bërtitnim me zë te lartë duke u sqaruar mes veti po pa u gjuajtur ,nena e ka dërguar babin qe te na qetësojë ,ne ishim duke u fjalosur pa u ndal dhe babai nga tha qe te qetësoheni ,por ishte e kotë se A.nuk u ndalke dhe vazhdojë me agresivitet ndaj babait, ku babai e goditi dy here ne fytyre dhe një here ne këmbë , gjë e cila është e vërtetuar nga mjeku .Vjen mami nga lartë pasi dëgjon zërin e A. dhe i vërsulet babit se ma mbyte vajzën , e qe ne realitet nuk ishte ne pyetje diçka e madhe por vetëm dy shuplaka “.

Gjykata gjithashtu pas administrimit të provave , analizimit të tyre më shumë kujdes gjatë shqyrtimit gjyqësor , ka konstatuar si jokontestues faktin se e akuzuara M. K. me datë, kohë dhe vend si ne piken e I-rë te aktakuzës , i shkakton lëndime trupore te dëmtuarit-bashkëshortit te saj A. K. , ne atë mënyrë qe i vërsulet te dëmtuarit A. dhe e godet në pjesën e majtë te fytyrës. Ky fakt është vërtetuar nga deklarata e dëshmitares K. K.-K., të dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor .Në pyetjen e parashtruar nga mbrojtësi i viktimave se a ke parë duke goditur baba nënën dhe anasjelltas nëna babën, dëshmitarja ka deklaruar :po të dy i kam parë , kur zbriti mami poshtë i është vërsulur babait duke i thënë se je ka do mi mbytt vajzën dhe babi ja kthen në të njëjtën mënyrë ku dhe vazhdoi përleshja mes tyre ,ku babi ka pasur gjak në faqe ndërsa te nëna dhe A.nuk kam vërejtur gjak. Andaj , gjykata ka ardh në përfundim se deklaratës së dëshmitares K. K. duhet ti falet besimi i plotë për shkak se dëshmia e saj është kuptimplotë dhe ajo që është shumë e rëndësishme deklarata e saj është në harmoni edhe me deklaratat e saj të mëparshme të dhëna para oficerëve policor dhe në prokurori , e po ashtu edhe nga deklarimi i të akuzuarit A. K. të dhënë në mbrojtjen e tij i cili ka deklaruar se lëndimet besojë se i kam marr nga Mira , meqenëse unë nuk e kam vërejtur veten në atë moment por nga policia jam dërguar në emergjencë ku janë konstatuar lëndimet .

Gjykata ka vlerësuar dhe analizuar me shumë kujdes pretendime të akuzuarës M. K. të dhënë në fjalën përfundimtare se me asnjë provë nuk vërtetohet se unë kam kryer këtë vepër penale sepse unë isha në vend punim dhe ky ka ardhur dhe e ka rrahur vajzën ku unë pasi kam zbritur poshtë që ta nxjerr vajzën nga duart e tij i njëjti nga pas më ka kapur për flokë dhe më ka goditur pas shpine e jo përpara, por Gjykata nuk ia fali besimin pretendimeve të akuzuarës të dhëna në mbrojtje dhe ka konstatuar se deklarimet e të akuzuarës janë të pabazuara dhe deklarative dhe vetëm përpjekje për ti ikur apo zvogëluar përgjegjësia penale , meqenëse një pretendim i tillë i të akuzuarës është e pa bazuar dhe në kundërshtim me akt ekspertizën ne ekspertit mjeko –ligjor Dr. N. U., i cili ka konstatuar se e dëmtuara-akuzuara M. K., ka gërvishtje në regjionin e majtë të fytyrës , regjionin e bërrylave të duarve dhe regjionin e mbi gjurin e djathtë , të shkaktuara nga veprimi mekanik i mjetit të fortë , mbretës (jo i mprehtë) me pasoja të përkohshme në shëndet, e jo në kokë apo në pjesën e pasme në shpinë, siç pretendon e akuzuara- e dëmtuara M. K. .

Andaj ,Gjykata nga provat e administruara ka konstatuar se në rastin konkret janë përmbushur të gjitha elementet e veprave penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par3 lidhur me par. 1 pika 1.1 të KPRK-ës.

Gjate marrjes se vendimit mbi dënimin ndaj te akuzuarve dhe llojit te tij ,Gjykata vlerësoi te gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese te parapara ne nenin 73 te KPRK-së, të cilat ndikojnë ne llojin dhe lartësinë e dënimit .

Si rrethanë lehtësuese për te akuzuarin A. K., mori për bazë personalitetin e të akuzuarit se është baba i 2 fëmijëve ,pranimin e fajësisë në çdo fazë të procedurës , sjelljen korrekte gjate shqyrtimit gjyqësor ,pendimin e shprehur ne gjykatë, kërkim falja nga të dëmtuarat për lëndimet e shkaktuara , premtimi se nuk do të kryej vepra të tilla apo të ngjashme ,e posaçërisht faktin e konstatuar nga data baza e gjykatës se i njëjti nuk ka qene i dënuar me pare ,te cilat rrethana ndikuan qe gjykata te akuzuarit ti shqiptojë dënim unik me burgim ne kohëzgjatje për 6(gjashtë) muajve , i cili dënim nuk do te ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës se verifikimit ne afatin prej 1(një) viti nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale ,me bindjen e plote se edhe me këtë dënim do te arrihet qëllimi i dënimit nga neni 41 te KPRK-ës .

Gjykata për te akuzuarën M. K. , si rrethanë lehtësuese mori personalitetin e saj se është nënë e 2 fëmijëve, sjelljen e mire gjate shqyrtimit gjyqësor ,gjendjen e dobët ekonomike si dhe faktin se e njëjta nuk ka qene e dënuar me pare ,te cilat rrethana ndikuan qe gjykata te akuzuarës ti shqiptojë dënim me burgim ne kohëzgjatje për 4(katër) muajve , i cili dënim nuk do te ekzekutohet nëse e akuzuara brenda kohës se verifikimit ne afatin prej 1(një) viti nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale ,me bindjen e plote se edhe me këtë dënim do te arrihet qëllimi i dënimit nga neni 41 te KPRK-ës .

Vendimi për udhëzimin e palëve të dëmtuara në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është marr konform nenit 463 par. 2 të KPPK-së, pasi qe gjykata gjate shqyrtimit gjyqësor nuk ka mundë te saktësojë lartësinë e demit qe te akuzuarit i kanë shkaktuar dhe të dhënat e mbledhura nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor bazohet ne dispozitat e nenit 450/1 dhe 2 nen par. 2.1 dhe 2.6 te KPK-së, ku janë të përfshira shpenzimet për ekspertizën mjekësore si dhe paushalli gjyqësor dhe shpenzimet në shumë prej 30.00 € për kompensimin e Viktimave të Krimit numër 05/036.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi .

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,
P. nr. 767/17 më datë 21.09.2018.**

**Sekretarja juridike,
Flutur Nagavci**

**Gj y q t a r j a,
Ilirjana Hoti**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi mund te paraqitet ankesë ,në afatin prej **15 ditësh** nga dita e marrjes se tij ne dorëzim Gjykatës se Apelit ne Prishtinë. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate.